

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ApNet Sh.p.k.

Neni 1
Emërtimi

- 1.1 Shoqëria ApNet SHPK (më poshtë quajtur “Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Zyra qendrore

- 2.1 Zyra qendrore e Shoqërisë është në adresën: *Lagja Kongresi Përmetit, Bulevardi “Jakov Xoxa”, pallati nr. 5, kati nr. 1, Fier.*
- 2.2 Shoqëria mund të hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit vendimmarrës.

Neni 3
Objekti

- 3.1 Ofrimi i shërbimit të komunikimeve elektronike, në veçanti në fushën e transmetimeve televizive kablore. Gjithashtu, shoqëria do të veproje për gjetjen dhe shtimin e klientëve për pale të treta duke promovuar dhe kryer marketing dhe shërbime të tjera të ngjashme në të gjitha format tregtare të ligjshme, në funksion të këtij qëllimi. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund: të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër; të blejë në mënyrë direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit; të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj. Shoqëria duhet të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë.

- 3.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "ApNet" Sh.p.k., është 100 (njëqind) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotën e tyre në kapitalin themeltar, në përputhje me kontributin e tyre.
- 5.2 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- 5.3 Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.4 Përqindja e pjesëmarrjes së secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë është:
1. Shoqëria "TEEB-CENTER" Sh.p.k. zotëron 1 kuotë me vlerë 85 Lekë, e barabartë me 85% të kapitalit themeltar
 2. Shoqëria "INTEL MEDIA" Sh.p.k. zotëron 1 kuotë me vlerë 15 Lekë, e barabartë me 15% të kapitalit themeltar.
- 5.5 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar

Neni 6

Zmadhimi i Kapitalit

- 6.1 Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 14 të këtij statuti.
- 6.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë. Në çdo rast këto kontribute duhet të shoqërohen me një çertifikatë për nënshkrimin e

tyre ose një raport vlerësimi teknik të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

Neni 7

Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me propozim të administratorit/ëve në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme, për zvogëlimin e kapitalit vendos me shumicën e përcaktuar në nenin 14 të këtij statuti.

Neni 8

Transferimi i kuotave

- 8.1 Transferimi i kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë bëhet sipas ligjit shqiptar. Kuotat janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi midis Ortakëve

- 9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme midis ortakëve. Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave.

Neni 10


Transferimi Tek Personat e Tretë

- 10.1 Personat e tretë jashtë Shoqërisë mund të bëhen zotërues të kuotave dhe të bëhen ortakë të Shoqërisë vetëm pas miratimit të Asamblesë së Përgjithshme, miratim i cili nuk mund të mos jepet pa arsye.

Neni 11

Organet e Shoqërisë

- 11.1 Organet e Shoqërisë janë:



1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Administratori/ët

Neni 12


Asambleja e Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe i merr vendimet kur është mbledhur rregullisht.
- 12.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët duke përfshirë edhe ata që mungojnë ose janë të përfaqësuar.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga dispozitat e këtij statuti, në rastet e parashikuara në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në ligje të tjera si dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.
- 12.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në zyrën qendrore të Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin me shkrim për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhje. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- 12.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme.
- 12.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Neni 13

Asambleja e Zakonshme

- 13.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, inventareve dhe llogarive vjetore.



- 13.2 Vendimet merren me shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.
- 13.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 13.2, asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 14


Asambleja e Jashtëzakonshme

- 14.1 Asambleja e Jashtëzakonshme thirret sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.
- 14.2 Vendimet që kanë të bëjnë me miratimin e ortakëve të rinj, me ndryshimin e neneve të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.
- 14.3 Vendimet e jashtëzakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave në prani të ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.
- 14.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 14.3, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi

- 15.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.
- 15.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë dhe marrjen e vendimeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila të përfshijë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 15.3 Ortakët, persona juridikë përfaqësohen në mbledhjet e Asamblesë vetëm nga përfaqësuesit e tyre ligjorë ose çdo person tjetër i pajisur me prokurë të posaçme të lëshuar nga organi kompetent i personit juridik.



Neni 16

Procesverbali i Mbledhjes

- 16.1 Në çdo mbledhje të Asamblesë mbahet procesverbal i cili përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe vendimet.
- 16.2 Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.


Neni 17

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme është kompetente për të vendosur për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve dhe vendos për shpërblimin e tij/tyre;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe vendos për shpërblimin e tyre;
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
 - j) shpërndarjen e fitimeve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky statut.

Neni 18

Administratorët



- 18.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, individë, të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas nenit 13 të këtij statuti.
- 18.2 Veprimet e administrimit të Shoqërisë në rast të dy administratorëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga të paktën njëri prej tyre dhe në rast të shumë se dy administratorëve veprimet konsiderohen të vlefshme nëse nënshkruhen të paktën nga 2 prej administratorëve të Shoqërisë.
- 18.3 Administratorët emërohen për një periudhë 5 (vjeçare) dhe mund të riemërohen.
- 18.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:

Z Kevin Lamçe , shtetas shqiptar, i biri i Maksim, i datëlindjes 09.09.1994, lindur në Fier me adrese ne Lagjia "Apollonia", Rruga Brigada 11 Sulemuese pall. 31, në Fier, identifikuar sipas ligjit me anë të Letërnjoftimit ID nr. 031493196 dhe Nr. Personal J409090780.

- 18.5 Administratorët shkarkohen/t nga detyra në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 13 te këtij statuti.

Neni 19

Kompetencat e Administratorëve

- 19.1 Administratorët janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e statutit ose ligjit të zbatueshëm.
- 19.2 Administratorët kanë të gjitha kompetencat e zakonshme për administrimin e veprimtarisë së përditshme të zakonshme të Shoqërisë, përveç atyre që sipas statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme dhe përveç kompetencave të cilat kufizohen si vijon:
- pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, administratori/ët nuk ka të drejtë të nënshkruajë ose zbatojë marrëveshje apo kontrata të çdo lloji, në veçanti marrëveshje apo kontrata huaje, kredie bankare, shitje ose blerje të pasurive të paluajtshme apo pasurie tjetër. Gjithashtu, administratori/ët, pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme nuk ka(në) të drejtë të kryej(n)ë asnjë

transaksion tjetër, pavarësisht llojit apo natyrës së tij, i cili tejkalon vlerën prej 2000 Euro (dymijë).

Neni 20

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 20.1 Eksperti kontabël i autorizuar emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas nenit 13 të këtij statuti, kur një emërim i tillë bëhet i detyrueshëm nga ligji në fuqi.

Neni 21

Viti Financiar

- 21.1 Viti financiar fillon më 1 Janar e përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 22

Fitimet

- 22.1 Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat e llogarive vjetore, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme rezervohen ose u shpërndahen ortakëve të Shoqërisë.
- 22.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e një rezerve të veçantë të Shoqërisë.

Neni 23


Prishja

- 23.1 Prishja e Shoqërisë dhe emërimi i likuidatorëve bëhet në bazë të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 24

Baza Ligjore

- 24.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin Shqiptar.
- 24.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e legjislacionit Shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.



24.3 Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti si dhe çdo konflikt që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve do të zgjidhet me vendim të Gjykatave Shqiptare.

Neni 25

Ndryshimet

25.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht ose një statut i ri mund të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.


Nënshkruar në Fier, sot më datë 03.03.2020

ORTAKËT

Shoqëria "INTEL MEDIA" Sh.p.k

Administratori

Hamza Himo



Shoqëria "TEEB-CENTER" Sh.p.k

Administratori

Illir Nathanaili

